



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 30 shtator 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

**Urdhër për parashtrime në lidhje me riklasifikimin e parashtrimeve të  
protokolluara**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit kujdestar të**  
**Nasim Haradinajt**  
Bastian Martens

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, ZPS-ja paraqiti kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve për Hysni Gucatin (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajn (“z. Haradinaj”), si dhe urdhrave përkatës për transferimin e tyre.<sup>2</sup>

2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet për z. Gucati dhe z. Haradinaj (bashkërisht “të dyshuarit”),<sup>3</sup> si dhe urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për lëshimin e fletarrestimeve dhe për urdhra në lidhje me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 35.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

3. Më 25 shtator 2020, të dyshuarit u arrestuan në Kosovë.<sup>5</sup> Z. Gucati u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së po atë ditë.<sup>6</sup> Z. Haradinaj u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më 26 shtator 2020.<sup>7</sup>

4. Më 28 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm caktoi të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Haradinaj më 29 shtator 2020.<sup>8</sup>

5. Më 29 shtator 2020, pasi shqyrtoi kërkesën e mbrojtësit të specializuar të z. Gucati, Gjykatësi i Vetëm caktoi të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Gucati më 1 tetor 2020.<sup>9</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat janë publike, përveçse kur Gjykatësi kompetent vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.

7. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet panelit kërkesë për riklasifikim. Gjithashtu, një panel mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces, apo *proprio motu*.

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00016, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimi të Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00023, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për caktimin e datës për paraqitjen e parë të Nasim Haradinajt*, 28 shtator 2020, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00029, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për caktimin e datës për paraqitjen e parë të Hysni Gucati*, 29 shtator 2020, publik.

### III. DISKUTIM

8. Duke pasur parasysh se të dyshuarit janë arrestuar dhe transferuar në objektin e paraburgimit të DHS-së, dhe se z. Haradinaj tashmë ka bërë paraqitjen e parë të tij, ndërsa z. Gucati pritet të paraqitet para Gjykatësit të Vetëm,<sup>10</sup> është e nevojshme të rishikohet klasifikimi i disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, në mënyrë që të respektohet parimi i procedurave publike i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit por edhe për parashtrimet e protokolluara, si edhe për çdo material tjetër në dosjen e çështjes.

9. Në këtë kontekst, vëmendje duhet t'i kushtohet, nga njëra anë, parimit të gjykimit publik, siç përcaktohet në nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, dhe, në anën tjetër, detyrës së Gjykatësit të Vetëm për të siguruar mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre, siç përcaktohet në nenin 23(1) të Ligjit.

10. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm ka përgjegjësinë të sigurojë që çdo parashtrim i protokolluar në dosjen e çështjes të ketë klasifikimin e duhur dhe, në përputhje me këtë, mund të riklasifikojë - *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë - çdo parashtrim të protokolluar, nëse arsyet për klasifikimin aktual nuk ekzistojnë më.

11. Gjykatësi i Vetëm synon të riklasifikojë si publike parashtrimet e mëposhtme rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07, duke pasur parasysh se të dyshuarit mbahen në paraburgim të DHS-së, se ata janë njoftuar për parashtrimet në fjalë, dhe se ato nuk përmbajnë informacione të ndjeshme që mund të rrezikojnë sigurinë e dëshmitarëve:

- F00005, 7 shtator 2020;

---

<sup>10</sup> *Shih* poshtëshënimet 8 dhe 9.

- F00007, 17 shtator 2020; dhe
- F00012, 24 shtator 2020, përfshirë shtojcat e klasifikuara si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

12. Duke pasur parasysh faktorët e lartpërmendur, si edhe hetimet në zhvillim e sipër të ZPS-së, Gjykatësi i Vetëm synon gjithashtu të riklasifikojë si konfidenciale dhe, sipas rastit, *ex parte*, parashtrimet e mëposhtme rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07:

- F00013, 24 shtator 2020;
- F00014, 24 shtator 2020; dhe
- F00017, 25 shtator 2020, përfshirë shtojcën.

13. Gjithashtu, është e përshtatshme që në këtë fazë t'i kërkohej Prokurorit të Specializuar të dorëzojë për protokollim versione konfidenciale (të redaktuara) dhe/ose publike (të redaktuara) të parashtrimeve të mëposhtme rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07:

- F00004, 7 shtator 2020;
- F00006, 16 shtator 2020;
- F00008, 21 shtator 2020, përfshirë shtojcën;
- F00009, 22 shtator 2020, përfshirë shtojcat;
- F00010, 23 shtator 2020, përfshirë shtojcën;
- F00011, 23 shtator 2020, përfshirë shtojcën; dhe
- F00028, 29 shtator 2020, përfshirë shtojcën.

14. Në rast se dëshiron të ruajë klasifikimin aktual të disa apo të të gjitha parashtrimeve të lartpërmendura, Prokurori i Specializuar duhet të specifikojë arsyet

për ruajtjen e klasifikimit aktual të tyre, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimeve përkatëse.

15. Gjithashtu, është e përshtatshme që në këtë fazë t'i kërkohej Administratores të dorëzojë për protokollim versione konfidenciale (të redaktuara) dhe/ose publike (të redaktuara) të parashtrimeve të mëposhtme rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07:

- F00015, 25 shtator 2020;
- F00016, 25 shtator 2020;
- F00018, 25 shtator 2020, përfshirë shtojcën;
- F00019, 25 shtator 2020;
- F00020, 26 shtator 2020, përfshirë shtojcën;
- F00021, 26 shtator 2020;
- F00022, 28 shtator 2020, përfshirë shtojcën;
- F00026/COR, 28 shtator 2020, përfshirë shtojcat; dhe
- F00031, 30 shtator 2020, përfshirë shtojcën.

16. Nëse ndonjë nga parashtrimet e lartpërmendura nuk mund t'u jepet të dy të dyshuarve, Administratorja ia dorëzon parashtrimin vetëm të dyshuarit përkatës. Në rast se dëshiron të ruajë klasifikimin aktual të disa apo të të gjitha parashtrimeve të lartpërmendura, Administratorja duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimeve përkatëse.

17. Gjithashtu, është e përshtatshme që në këtë fazë t'i kërkohej Mbrojtjes së z. Gucati të dorëzojë një version publik (të redaktuar) të parashtrimit të mëposhtëm konfidencial në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07:

- F00025/COR, 28 shtator 2020.

18. Në rast se dëshiron të ruajë klasifikimin aktual të parashtrimit të lartpërmendur, Mbrojtja e z. Gucati duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

#### IV. VENDIM

19. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- KËRKON** nga Prokurori i Specializuar që deri më **14 tetor 2020** të paraqesë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07, të specifikuara në paragrafin 17 të këtij urdhri, ose të dorëzojë për protokollim versione konfidenciale (të redaktuara) dhe/ose publike (të redaktuara) të tyre;
- KËRKON** nga Mbrojtja e z. Gucati që deri më **14 tetor 2020** të paraqesë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të parashtrimit të protokolluar në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07, të specifikuar në paragrafin 17 të këtij urdhri, ose të dorëzojë për protokollim një version publik (të redaktuar) të tij; dhe
- KËRKON** nga Administratorja që deri më **14 tetor 2020** të paraqesë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-07, të specifikuara në paragrafin 15 të këtij urdhri, ose të dorëzojë për protokollim versione konfidenciale (të redaktuara) dhe/ose publike (të redaktuara) të tyre.

nënshkrimi

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Vetëm**

E mërkurë, 30 shtator 2020.

Në Hagë, Holandë.